



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 23957 Lr

Shkodër, më 17.11.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni


KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: Për miratimin e zbatimit të projektit Arti për Evropën (ARTE), në kuadër të Programit CERV – Network of Towns.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____._____.2025

“PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT ARTI PËR EVROPËN (ARTE), NË KUADËR TË PROGRAMIT CERV – NETWORK OF TOWNS.

Këshilli i Bashkisë Shkodër sot me datë _____._____.2025, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Ligji nr. 115/2024, datë 03.12.2024 ‘Për buxhetin e vitit 2025, i ndryshuar; Udhëzimi Plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, i ndryshuar; ligjit nr. 45/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Qytetarët, barazia, të drejtat dhe vlerat”; Udhëzimi nr. 10, datë 12.07.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordinin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”; Deklarata e Nderit datë 02.09.2025 ndërmjet ESCOOP si partner lider dhe Bashkisë Shkodër, Desincoop, Bashkisë Tuz dhe ARSIS si partnerë; Marrëveshja e grantit Projekti 101249667 — ARTE, administruar në Bashkinë Shkodër me nr. prot 4515/b, datë 18.11.2025; VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____ prot., datë _____ të administratës së Bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Për miratimin e zbatimit të projektit Arti për Evropën (ARTE), në kuadër të Programit CERV – Network of Towns, me financim të planifikuar në programin buxhetor afatmesëm 2026–2028. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit CERV (Citizens, Equality, Rights and Values Programme – Programi për Qytetarët, Barazinë, Të Drejtat dhe Vlerat), dhe udhëhiqet nga ESCOOP si Partner Lider.

2. Vlera totale e financimit për Bashkinë Shkodër do të jetë **59,005 euro**, e konvertuar në lekë në shumën **5,750,037 Lekë**. Kontributi i BE-së mbulon 100% të kostove dhe nuk nevojitet bashkëfinancim. Projekti shtrin efektet financiare për 24 muaj, duke filluar nga janari 2026.
3. Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e **TVSH-së** e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori, shuma **779,697 lekë**, e cila do të parashikohet me kërkesat buxhetore të PBA 2026-2028.

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin **AC141: “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural”**, sipas detajimit:

Buxheti total në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2026	2,531,166			2,531,166		
Shuma 2027	3,998,568			3,998,568		
Shuma totale e Projektit	6,529,734			6,529,734		

Buxheti me burim financimi donacion në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2026	2,401,655			2,401,655		
Shuma 2027	3,348,382			3,348,382		
Shuma totale Financim nga donatori	5,750,037			5,750,037		

**Buxheti me burim financimi fondet e veta në lekë
(Shpenzime për TVSH)**


Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2026	129,511			129,511		
Shuma 2027	650,186			650,186		
Shuma totale Buxheti me fondet e veta	779,697			779,697		

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



KRYETAR
Bret BECI


Zy. Kryetar



Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar



Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor



Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qendrueshëm Ekonomik



Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Mbështetëse



Drejtoria Juridike



Drejtoria e Financës



Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM EKONOMIK

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____._____.2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT ARTI PËR EVROPËN (ARTE), NË KUADËR TË PROGRAMIT CERV – NETWORK OF TOWNS.

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit “ARTE – Arti për Evropën”, një iniciativë e rëndësishme që zhvillohet në kuadër të programit CERV – Network of Towns, në bashkëpunim me organizatën jofitimprurëse ESCOOP – European Social Cooperative – “Bashkëpunimi Social Evropian”, e cila mban rolin e partnerit lider.

Ky projekt ndërkombëtar synon të bashkojë partnerë nga vende të ndryshme për të afruar të rinjtë me vlerat dhe frymën e Bashkimit Evropian. Nëpërmjet artit, kulturës dhe dialogut ndërkulturor, ky projekt synon të krijojë një hapësirë reflektimi mbi arritjet e BE-së dhe ndikimet pozitive që projektet e saj kanë sjellë në jetën e qytetarëve. Projekti fton të rinjtë të mendojnë përtej kufijve kulturorë dhe gjeografikë, duke i bashkuar rreth idesë së unitetit dhe përkatësisë ndaj një trashëgimie të përbashkët europiane.

Në qendër të projektit qëndrojnë të rinjtë e moshës 18–30 vjeç, të cilët do të jenë pjesë aktive e aktiviteteve të shumta që do të zhvillohen në bashkëpunim me Qendrën Rinore “Atelie”, maturanët e shkollave të mesme të qytetit dhe Universitetin “Luigj Gurakuqi”. Përmes eventeve ndërkombëtare, takimeve online dhe shkëmbimeve kulturore, të rinjtë do të kenë mundësinë të njihen më shumë me njeri-tjetrin, të ndajnë përvoja dhe të ndërtojnë ura bashkëpunimi që forcojnë ndjenjën e solidaritetit dhe bashkimit evropian.

Projektvendimi i propozuar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak ka për qëllim miratimin për zbatimin e projektit “Arti për Evropën” (ARTE) në kuadër të Thirrjes CERV-2025-CITIZENS-TOWN-NT.

Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i kapaciteteve institucionale dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, shkollave, organizatave kulturore dhe aktorëve të tjerë lokalë. Projekti e trajton kulturën si një hapësirë dialogu dhe përfshirjeje, ku arti shërben si gjuhë e përbashkët për shprehjen e emocioneve, ndjenjës së përkatësisë dhe identitetit individual e kolektiv.

Projekti ARTE synon të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të Bashkimit Evropian përmes shprehjes artistike, duke bashkuar njerëz që jetojnë në vendet e BE-

së dhe në vendet që janë në procesin e anëtarësimit, si Shqipëria dhe Mali i Zi. Ky qëllim do të arrihet përmes aktiviteteve të mëposhtme:

1. **TRAJNIM ONLINE** që do të përfshijë pjesëmarrës të rinj nga të gjitha vendet partnere së bashku për të mësuar rreth historisë/procesit të themelimit dhe zgjerimit të Bashkimit Evropian, akteve kryesore dhe momenteve kyçe, prezantimin e praktikave më të mira të bashkëpunimit të frytshëm midis njerëzve dhe organeve në vendet e BE-së dhe vendet që po anëtarësohen. Nga Shkodra do të trajnohen 150 të rinj, ku për 3 muaj do të zhvillohen 4 trajnime online. Qendra Rinore “Atelie”, maturat e shkollave të mesme dhe studentët nga universiteti do të luajnë një rol të rëndësishëm në mbarrëvajtjen e aktiviteteve.

2. **PUNËTORI LOKALE** që do të organizohen në secilin vend partner dhe përfshijnë grupe të rinjsh për të shprehur artistikisht vizionin e tyre për Evropën, pritjet e tyre që rrjedhin nga të qenit (ose të bërit) qytetar evropian në aspektin e rritjes personale, marrëdhënieve shoqërore, karrierës, etj. Atyre do t'u kërkohet të reflektojnë mbi ndjenjën e tyre të përkatësisë në BE, gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë aktive në jetën e saj sociale, ekonomike dhe kulturore, për të udhëtuar lirisht për kënaqësi, studim, vullnetarizëm ose punë, për të kontribuar në zhvillimin dhe rritjen e qëndrueshme dhe të drejtë të BE-së. Shprehjet artistike do të mbështeten në gjuhë të ndryshme, bazuar në prijet individuale, dhuratat, kapacitetet (këndim, pikturë, vizatim, vallëzim, luajtje instrumentesh, etj.). Produktet artistike që do të krijohen do të shfaqen/ tregohen/ përfaqësohen gjatë eventeve ndërkombëtare. Do të zhvillohen 12 punëtori, çdo muaj do të përfshihen 10 të rinj për secilin ëorkshop në lokacione të ndryshme.

3. **EVENTE NDËRKOMBËTARE:** 1 në Itali, 1 në Portugali dhe 1 në Shqipëri. Gjatë këtyre eventeve do të organizohen seminare dhe debate për t'u mundësuar të rinjve, mysafirëve dhe ekspertëve ndërkombëtarë (rreth 15 të ftuar) të njohin më në detaje historinë dhe arritjet e BE-së dhe të shprehin mendimet e tyre rreth funksionimit dhe politikave të BE-së, të kuptojnë përfitimet e të qenit pjesë e BE-së dhe të përforcojnë kohezionin e saj shoqëror dhe politik.

Në projekt marrin pjesë 5 partnerë, Bashkia Shkodër, ESCOOP – European Social Cooperative, Organizata DESINCOOP (Portugali), Komuna Tuz (Mali i Zi) dhe organizata ARSIS (Greqi). Referuar kushteve dhe udhëzimeve të Programit CERV (Citizens, Equality, Rights and Values Programme - Programi për Qytetarët, Barazinë, Të Drejtat dhe Vlerat), Bashkia Shkodër angazhohet të zbatojë projektin në përputhje me manualin, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Programi lidhur me këtë kontratë, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Partnerët përfitues:

Nr.	Roli	Akronimi	Emri Ligjor	Vendi	Shuma e Grantit
1.	Koordinator	ESCOOP	European Social Cooperative	Itali	59,005 EUR

2.	Përfitues	MOSH	Bashkia Shkodër	Shqipëri	59,005 EUR
3.	Përfitues	DESINCOOP	Desenvolvimento Económico, Social E Cultural CRL	Portugali	59,005 EUR
4.	Përfitues	TUZI	Komuna E Tuzit	Mali i Zi	26,390 EUR
5.	Përfitues	ARSIS	Arsis Koinoniki Organosi Ypostirixis Neon	Greqi	24,645 EUR

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 24 muaj nga data e nënshkrimit nga të gjithë partnerët dhe shtrin efektet e tij financiare nga janari 2026. Buxheti total i projektit ARTE është 228,050 euro. Vlera e buxhetit për Bashkinë Shkodër do të jetë 59,005 euro, e konvertuar në lekë në shumën 5,750,037 Lekë, sipas kursit zyrtar 97.45 ALL marrë nga InforEuro për muajin shtator 2025 (që përkon me datën kur është nënshkruar Deklarata e Nderit). Kontributi i BE-së mbulon 100% të kostove dhe nuk nevojitet bashkëfinancim.

Vlera do të transferohet për llogari të Bashkisë Shkodër sipas Udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”.

Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në dy këste: 60% e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Partneri Lider; 40% e buxhetit do të transferohet pas raportimit final dhe njohjes së shpenzimeve. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër merr angazhimin që vlerën e kështit të dytë (40%), 2,300,015 lekë, ta parashikojë me kërkesat buxhetore në PBA 2026-2028 dhe ta vendosë në dispozicion të zbatimit të projektit. Në momentin e miratimit të raportit final dhe njohjes së shpenzimeve të projektit nga donatori, kjo shumë do të rimburohet.

Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e TVSH-së e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori, shuma **779,697 lekë** për shpenzime operative.

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin **AC141: “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural.”** sipas detajimit:

Buxheti total në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara

Shuma 2026	2,531,166			2,531,166		
Shuma 2027	3,998,568			3,998,568		
Shuma totale e Projektit	6,529,734			6,529,734		

Buxheti me burim financimi donacion në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2026	2,401,655			2,401,655		
Shuma 2027	3,348,382			3,348,382		
Shuma totale Financim nga donatori	5,750,037			5,750,037		

**Buxheti me burim financimi fondet e veta në lekë
(Shpenzime për TVSH)**

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2026	129,511			129,511		
Shuma 2027	650,186			650,186		
Shuma totale Buxheti me fondet e veta	779,697			779,697		

Vlerësojmë të rëndësishme të nënvizojmë që Bashkia Shkodër do të ndjekë të gjitha procedurat për rimbursimin e vlerës së TVSH pranë SASPAC – Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Sa më sipër, kërkohet miratimi i shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, në programin P.AC141: Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural

K R E T A R
Beni BECI



Belum Nama 

Stela Mandusea

Nr. 4	P.AC141.Q1.O1.A4. Projekti Arti për Europën (ARTE)	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit "ARTE – Arti për Europën", i cili është pjesë e programit CERV – Network of Towns, në bashkëpunim me organizatën jofitimprurëse ESCOOP – European Social Cooperative – Cooperativa Sociale Europea (Partneri Lider në projekt). Partner të tjerë në këtë projekt janë Komuna Tuz e Malit të Zi, organizata DESINCOOP (Portugali) dhe organizata ARSIS (Greqi). Projekti synon të bashkojë të rinjtë nga vende të ndryshme për të reflektuar mbi arritjet e BE-së dhe ndikimet pozitive të iniciativave të financuara nga ajo, duke krijuar ndjenjën e unitetit dhe tejkalimin e dallimeve kulturore dhe gjeografike. Përmes eventeve ndërkombëtare dhe takimeve online, projekti do të promovojë shkëmbimin kulturor dhe bashkëpunimin midis të rinjve, duke forcuar ndjenjën e përkatësisë ndaj një trashëgimie të përbashkët evropiane si bazë për të ardhmen. Projekti fokusohet kryesisht tek të rinjtë 18-30 vjeç, të cilët do të jenë në qendër të të gjitha aktiviteteve në bashkëpunim me Qendrën Rinore “Atelie”, maturat e shkollave të mesme të qytetit dhe Universitetin “Luigj Gurakuqi”. Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i kapaciteteve institucionale dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, shkollave, organizatave kulturore dhe aktorëve të tjerë lokalë. Projekti e trajton kulturën si një hapësirë ndërveprimi dhe përfshirjeje, ku arti shërben si gjuhë e përbashkët për shprehjen e ndjenjave, përkatësisë dhe identitetit individual e kolektiv. Përmes aktiviteteve ndërdisiplinore dhe pjesëmarrëse, rinia zë një rol qendror në zbatimin e projektit, duke u përfshirë në proceset krijuese, edukative dhe bashkëpunuese që lidhen me artin, trashëgiminë dhe qytetarinë aktive. Në këtë mënyrë, projekti mbështet vizionin e Bashkisë Shkodër për të vendosur kulturën dhe krijimtarinë në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të forcimit të identitetit qytetar. Konkretisht ai mbështetet në 4 shtylla kryesore: Organizimi i eventeve ndërkombëtare në secilin nga vendet partnere Itali, Shkodër dhe Portugali ku do të mirëprehen rreth 15 të ftuar. Trajnime on-line: Do të zhvillohen para punësive lokale dhe do të përfshijnë rreth 150 pjesëmarrës të rinj për 4 trajnime, për të mësuar rreth historisë/procesit të krijimit dhe zgjerimit të Bashkimit Evropian, aktet dhe momentet kryesore dhe më të rëndësishme, prezantimin e praktikave më të mira të bashkëpunimit, mundësitë për të rinjtë për të udhëtuar, studiuar dhe punuar në vende të tjera të BE-së. Punëtori artistike dhe kulturore vendore - Në çdo vend partner do të përfshihen grupe të rinjsh për të shprehur artistikisht vizionin e tyre për Evropën, pritshmëritë e tyre që rrjedhin nga të qenit (ose të bëhesh për pjesëmarrësit shqiptarë dhe malazezë) një qytetar evropian për sa i përket rritjes personale, marrëdhënieve sociale, karrierës, etj. Shprehjet artistike do të mbështeten në gjuhë të ndryshme, bazuar në këngë, piktura, shfaqje kërcimi, etj.). Produktet artistike që do të krijohen gjatë punësive do të prezantohen në një panair/ekspozitë gjatë ngjarjeve ndërkombëtare. Do të zhvillohen 12 punëtori, çdo muaj do të përfshihen 10 të rinj për secilin ëorkshop në lokacione të ndryshme. Hartimi dhe nënshkrimi i Deklaratës së Bashkëpunimit nga të gjitha Bashkitë e përfshira në projekt të paktën 2 vite pas mbarimit të projektit, përmes së cilës ato do të angazhohen për të krijuar një rrjet të qëndrueshëm qytetesh, falë të cilit do të thellojnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin mes tyre, duke skicuar një vizion afatgjatë për të ardhmen e integritit evropian që do të kontribuojë në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve të tyre në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike evropiane si dhe në zhvillimin e saj të qëndrueshëm.		

Kohëzgjatja e projektit është 24 muaj, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës nga të gjithë partnerët. Buxheti total i projektit ARTE është 228,050 euro. Buxheti i dedikuar për Bashkinë Shkodër do të jetë 59,005 Euro (5,750,037 Lekë) për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Kontributi i BE-së mbulon 100% të kostove dhe nuk nevojitet bashkëfinancim.

Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në dy këste: 60% e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Partneri Lider; 40% e buxhetit do të transferohet pas raportimit final dhe njohjes së shpenzimeve. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër merr angazhimin që vlerën e kështit të dytë, 2,300,015 lekë, ta parashikojë me kërkesat buxhetore në PBA 2026-2028 dhe ta vendosë në dispozicion të zbatimit të projektit. Në momentin e miratimit të raportit final dhe njohjes së shpenzimeve të projektit nga donatori, kjo shumë do të balancohet me kështin e dytë.

Vlera e TVSH-së është shpenzim që nuk mbulohet me fondet e Bashkimit Evropian. Shpenzimet e TVSH-së do të financohen me fondet e bashkisë, me vlerë 779,697 lekë të cilat do të alokohen në programin AC141: Mbështetja për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural, për shpenzime operative.

ii. Synimi i projektit

Qëllimi i projektit ARTE është të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të Bashkimit Evropian përmes shprehjes artistike. Projekti bashkon të rinj nga vendet anëtare të BE-së dhe nga Shqipëria e Mali i Zi, që janë ende në procesin e anëtarësimit në BE.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Trajnime online, ku të rinjtë do të njihen me historinë e BE-së, procesin e zgjerimit, aktet kryesore dhe shembujt më të mirë të bashkëpunimit midis vendeve anëtare dhe atyre në proces anëtarësimi.
2. Punëtori lokale, që do të zhvillohen në secilin vend partner, ku të rinjtë do të shprehin në mënyrë artistike vizionin e tyre për Evropën dhe çfarë do të thotë për ta të jenë (ose të bëhen) qytetarë evropianë.
3. Evente Ndërkombëtare që do të zhvillohen në Itali, Portugali dhe Shqipëri. Këto ngjarje do të përfshijnë seminare, debate dhe prezantime artistike, duke krijuar hapësira për dialog midis qytetarëve vendas dhe pjesëmarrësve ndërkombëtarë mbi vlerat dhe funksionimin e BE-së.

b) Rezultatet që prisni

- Angazhimi i të rinjve në aktivitete evropiane;
- Krijimi i lidhjeve dhe partneriteteve ndërkombëtare;
- Vazhdimësia dhe përfundimi i angazhimit të Bashkisë Shkodër në projekte ndërkombëtare, në përputhje me strategjitë e saj për zhvillim dhe integrim evropian;
- Përhapja e njohurive dhe përvojave të fituara.

c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)

Bashkia Shkodër
Komuniteti
Organizatrat kulturore
Qendra Rinore "Atelie"
Shkollat e mesme të qytetit
Universiteti "Luigj Gurakuqi"

d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)

ESCOOP
Bashkia Shkodër
Komuna e Tuzit
Organizata DESINCOOP (Portugali)
Organizata ARSIS (Greqi)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (në lekë)	Nga kjo				
			Paga	Siguri me	Operative	Transf erime	Kapit ale
A.1	Shërbim Ekspertizë e Jashtme (donatori)						
A.1.1	Ekspert i jashtëm – Koordinator për organizimin e workshopeve (donatori)	584,700			584,700		
A.1.2	Ekspert i jashtëm – Artist (pikturë/skulpturë) (donatori)	584,700			584,700		
A.1.3	Ekspert i jashtëm për çështjet e BE-së (donatori)	584,700			584,700		
A.2	Blerje materiale didaktike dhe promocionale për organizimin e trajnimeve dhe ëorkshopeve (donatori)	647,555			647,555		
A.3	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë)	129,511			129,511		
	Shuma 2026	2,531,166			2,531,166		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (në lekë)	Nga kjo				
			Paga	Siguri me	Operative	Transf erime	Kapit ale
A.1	Organizimi i Eventit Ndërkombëtar (donatori)	1,301,932			1,301,932		
A.2	Shërbim Ekspertizë e jashtme – Përkthyes (donatori)	97,450			97,450		
A.3	Shpenzime për akomodim dhe udhëtim (donatori)	1,949,000			1,949,000		
A.4	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë)	650,186			650,186		
	Shuma 2027	3,998,568			3,998,568		
f) Periudha e zbatimit 2026,2027			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				